



Nr. 23 /2023  
Datë: 05.04.2023

**Agjencia për Informim dhe Privatësi**, zyrtari i inspektimit, duke vepruar në pajtim me nenin 68, nenin 69, paragrafi 1, nenin 71, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 dhe 1.6, si dhe nenin 92, paragrafin 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas kryerjes së inspektimit sipas detyrës zyrtare tek kontrolluesi “Partia Socialdemokrate”, nxjerr këtë:

### **V E N D I M**

1. Shqiptohet gjobë kundërvajtëse me vlerë prej **20,000.00 € (njëzetmijë euro)**, ndaj “Partia Socialdemokrate”, me adresë në rr. “Bajram Kelemendi”, nr. 68, Prishtinë, në cilësinë e kontrolluesit, për përpunimin e kundërligjshëm të të dhënave personale.
2. **Urdhërohet** “Partia Socialdemokrate”, në cilësinë e kontrolluesit, me adresë në rr. “Bajram Kelemendi”, nr. 68, Prishtinë, të shkatërroj të gjitha listat me të dhëna personale të grumbulluara me rastin e peticionit të vitit 2015.
3. **Obligohet** “Partia Socialdemokrate” që shumën e përcaktuar nga pika 1 e këtij vendimi ta paguajë në afat prej 30 ditësh, në xhironlogarinë e Agjencisë për Informim dhe Privatësi Nr. 1000400070005127/ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
4. Me kalimin e afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, i njëjti kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Përmbartuesi Privat.
5. **Obligohet** “Partia Socialdemokrate”, që brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të njoftojë Agjencinë me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### **ARSYETIM**

Agjencia për Informim dhe Privatësi (*Agjencia*), më datë 06.03.2023, përmes mediave është njoftuar lidhur me aktivitetin e Partisë Socialdemokrate (PSD) që kishte zhvilluar para objektit të Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK), me ç’ rast ka shpalosur lista e nënshkruara nga

qytetarët të cilët kanë nënshkruar Peticionin e vitit 2015 kundër marrëveshjeve të nënshkruara me 25 gusht 2015 me Republikën e Serbisë.

Bazuar në nenin 68, paragrafi 1, dhe nenin 69, të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP), Agjencia, pas pranimit të informacionit nga mediat, përmes zyrtarëve të inspektimit, menjëherë në po të njëjtën datë, ka filluar procedurën e inspektimit për të vërtetuar gjendjen faktike. Inspektimi ka filluar në vendin ku janë shpalosur këto lista, para ndërtesës së QRK, ku zyrtarët e inspektimit kanë hasur në listat e shpalosura në oborrin e ndërtesës, që njëherë është rrugë e qasshme për kalimtarët dhe në vetura të parkuara para ndërtesës. Gjatë kontrollimit të këtyre listave është vërtetuar se këto lista janë listat e grumbulluara në vitin 2015, gjatë nënshkrimit të peticionit kundër katër (4) marrëveshjeve të datës 25 gusht 2015 të nënshkruara me Serbinë. Çdo listë mbanë titullin PETICION dhe është i paraqitur ky tekst: *“Ne, qytetarët e Republikës së Kosovës të nënshkruar në këtë peticion, i kundërshtojmë katër marrëveshjet e datës 25 gusht 2015 të nënshkruara me Serbinë, që lidhen me krijimin e Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe në Kosovë, (2) barrikadën në Urën e Ibrit në Mitrovicë, (3) Kodin telefonik shtetëror dhe (4) marrëveshjen për energjinë, si dhe marrëveshjen për demarkacionin me Malin e Zi. Këto marrëveshje me Serbinë e ndajnë Kosovën në vija etnike duke krijuar një entitet të ri politik serb brenda Kosovës që rrezikon copëtimin e territorit, mosfunksionimin e shtetit, pengimin e zhvillimit ekonomik dhe çon drejt një bashkëqeverisje të Kosovës me shtetin e Serbisë, i cili nuk e njeh pavarësinë e Republikës së Kosovës. Edhe marrëveshja me Malin e Zi është brenda së njëjtës linjë që çon drejtë humbjes së territorit të Republikës së Kosovës. Këto marrëveshje nuk i përfaqësojnë interesat e qytetarëve të Kosovës dhe ato janë diskriminuese në baza etnike. Qytetarët e Kosovës nuk ia kanë dhënë asnjëherë mandatin Qeverisë së Kosovës që të pranoj marrëveshje të tilla. Rrjedhimisht : Ne qytetarët e Republikës së Kosovës të nënshkruar në këtë peticion, kërkojmë nga Qeveria e Republikë së Kosovës që të tërheq menjëherë nënshkrimin nga katër marrëveshjet e datës 25 gusht 2015 të nënshkruar me Serbinë si dhe nga marrëveshja për demarkacion me Malin e Zi. (Subjektet politike nismëtar të këtij peticioni janë: Lëvizja VETËVENDOSJE, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe NISMA për Kosovën)”. Pas këtij teksti janë tabelat të cilat përmbajnë të dhëna personale të qytetarëve, duke përfshirë kategorinë e të dhënave si: **emri, mbiemri, komuna, numri personal, data, numri i telefonit dhe nënshkrimi.***

Para ndërtesës së QRK kanë qenë prezent pjesëtarët e Policisë së Kosovës, ku janë këshilluar nga zyrtarët e inspektimit që listat t’i sigurojnë në një ambient të sigurt, për të mos pasur qasje personat e paautorizuar. Më pas Partia Socialdemokrate përmes një njoftimi në faqen zyrtare të saj dhe në platformën Facebook, ka njoftuar lidhur me aktivitetin e realizuar, duke nënkuptuar se pjesë e këtyre listave janë 205.000 qytetarë të cilët kanë nënshkruar këtë peticion.

Më pas, më datë 10.03.2023, zyrtarët e inspektimit kanë zhvilluar inspektimin tek selia e kontrolluesit dhe është hartuar procesverbali nr. 04/2023, me numër serik 000030. Në procesverbal është konstatuar se:

*“Kontrolluesi, listat e qytetarëve që kanë nënshkruar peticionin e vitit 2015 e ka që nga realizimi i këtij aktiviteti në vitin 2015. Këto lista janë publikuar para ndërtesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, gjatë aktivitetit publik kundër marrëveshjes për Asociacionin e komunave serbe, në prani të mediave dhe policisë. Kontrolluesi deklaron se nuk ka kopje të tjera të këtyre listave. “*

Në procesverbal kontrolluesi ka dhënë këtë vërejtje: *“Asnjë e dhënë nuk është publikuar nga ky aksion publik e politik”*

Agjencia për Informim dhe Privatësi si një institucion i pavarur e ruan të drejtën themelore për mbrojtjen e të dhënave personale. Mbrojtja e të dhënave personale është e mbrojtur me nenin 36, paragrafin 4 të Kushtetutës së Kosovës, e cila parasheh si në vijim: *“Secili person gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. Mbledhja, ruajtja, qasja, korrigjimi dhe shfrytëzimi i tyre rregullohet me ligj”*.

Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP), përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë e individit. Sipas nenit 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, të LMDhP-së, e **dhënë personale** konsiderohet çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (“subjekt i të dhënave”); një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues *online*, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik. Sipas këtij përkufizimi, të dhënat që gjenden në listat e peticionit konsiderohen të dhëna personale.

Në kontekstin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë së individit, publikimi apo shpërndarja e të dhënave personale nënkupton përpunim të të dhënave. Kur kemi të bëjmë me përpunimin e të dhënave personale, Ligji, në dispozitat e tij ka dhënë kuptimin se cilat veprime konsiderohen si përpunim i të dhënave personale, gjegjësisht neni 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të LMDhP-së, përcakton se me **përpunim** nënkuptohet çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi

Ndërsa, përkufizimi i shprehjes ‘kontrollues i të dhënave’ është i përcaktuar në nenin 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11 të LMDhP-së, me të cilin nënkuptohet se **kontrollues** i të dhënave është çdo person fizik apo juridik nga sektori publik ose privat që individualisht ose së bashku me të tjerët përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale. Në këtë rast, sipas përkufizimeve të ligjit, kontrollues i të dhënave cilësohet ‘Partia Socialdemokrate’ (PSD), pasi që e njëjta ka përcaktuar qëllimin e përpunimit të të dhënave.

LMDhP, në nenin 4, ka përcaktuar parimet themelore për përpunimin e të dhënave personale që duhen respektuar me rastin e përpunimit të të dhënave personale, siç janë: parimi i ligjshmërisë, parimi i kufizimit të qëllimit, parimi i minimizimit të të dhënave, parimi i saktësisë, parimi i kufizimit të ruajtjes, parimi i paprekshmërisë dhe konfidencialitetit dhe në fund, parimi i llogaridhënies, i cili përcakton se kontrolluesi duhet të jetë përgjegjës dhe në gjendje të zbatojë përputhshmërinë e të gjitha parimeve të përcaktuara si më lart.

Parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës përcakton se të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave. Parimi i ligjshmërisë është parim i një rëndësie të veçantë për çështjen e bazës ligjore, pasi është një nga përbërësit kryesorë të nevojshëm që përpunimi të jetë i ligjshëm. Drejtësia

nënkupton që përpunimi duhet të bëhet në mënyra që njerëzit do të prisnin në mënyrë të arsyeshme dhe jo në mënyra që kanë efekte negative të pajustificuara mbi ta. Ndërsa, transparenca nënkupton se kontrolluesi duhet, gjithashtu, t'i ofrojë subjekteve të të dhënave personale informacion të qartë dhe transparent në lidhje me qëllimin ose qëllimet e përpunimit të të dhënave të tyre personale dhe bazën ligjore për ta bërë këtë.

Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale është kur zbatohet, së paku, një nga kriteret e paraparë në nenin 5 të LMDhP-së, me të cilën kontrolluesi do të legjitimonte përpunimin e të dhënave, që nënkupton se të dhënat personale duhet të përpunohen vetëm në përputhje me ligjin.

Sipas nenit 5, paragrafi 1, të LMDhP-së, përpunimi i të dhënave personale, përpunimi është i ligjshëm vetëm nëse zbatohet, të paktën, njëri nga kriteret e mëposhtme: 1.1. nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij për përpunimin e të dhënave të tij personale për një ose më shumë qëllime specifike; 1.2. nëse përpunimi është i domosdoshëm për përmbushjen e një kontrate, në të cilën subjekti i të dhënave është palë kontraktuese ose për të ndërmarrë veprimet lidhur me kërkesën e subjektit të të dhënave para lidhjes së kontratës; 1.3. nëse përpunimi është i domosdoshëm për respektimin e obligimit ligjor, të cilit i nënshtrohet kontrolluesi; 1.4. nëse përpunimi është i domosdoshëm për mbrojtjen e interesave jetike të subjektit të të dhënave ose personave të tjerë fizikë; 1.5. nëse përpunimi është i domosdoshëm për kryerjen e një detyre me interes publik ose për ushtrimin e autoritetit zyrtar që i është dhënë kontrolluesit; 1.6. nëse përpunimi është i domosdoshëm për qëllime të interesave legjitime të ushtruara nga kontrolluesi ose pala e tretë, përveç kur këto interesa tejkalohen nga interesat apo të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave që kërkon mbrojtjen e të dhënave personale, veçanërisht nëse subjekti i të dhënave është fëmijë. Kjo nuk zbatohet për përpunimin e kryer nga autoritetet publike për përmbushjen e detyrave të tyre.

Nismëtarë të këtij peticioni kanë qenë këto subjekte politike: Lëvizja Vetëvendosje, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nisma për Kosovë, e rrjedhimisht, vetëm këto subjekte kanë mundur të kenë qasje në këto lista, pasi që qytetarët kanë ofruar të dhënat e tyre për këto subjekte politike. Ndërsa, Partia Social Demokrate, duke mos qenë etnitet në këtë nismë nuk ka bazë ligjore t'i posedojë këto lista. Gjithsesi, posedimi i këtyre listave nuk e legjitimon këtë subjekt që të përpunojë të dhënat personale të mbledhura në këto lista dhe t'i përdorë për aktivitetet e saj.

Në anën tjetër, në këndvështrim të Ligjit nr.06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale përpunimi i të dhënave personale është e lidhur ngushtë me qëllimin e përpunimit dhe kështu parimi i kufizimit të qëllimit luan një rol të rëndësishëm për të siguruar që përpunimi të ketë një bazë ligjore të vlefshme. Parimi i kufizimit të qëllimit nënkupton se të dhënat personale grumbullohen vetëm për qëllime të caktuara, të qarta dhe legjitime dhe nuk mund të përpunohen më tutje në kundërshtim me këto qëllime.

Qëllimi i peticionit të zhvilluar ka qenë dërgimi i këtij peticioni tek organet kompetente për shqyrtimin e kësaj nisme, që nënkupton dërgimin në Kuvendin e Kosovës, që në kuptim të LMDhP-së përfundon edhe qëllimi i përpunimit të të dhënave. Me rastin e përmbushjes së qëllimit të përpunimit, bazuar në parimin e kufizimit të ruajtjes, të dhënat personale asgjësohen,

fshihen, shkatërrohen, bllokohen ose bëhen anonime, përveç nëse është paraparë ndryshe me Ligjin përkatës për Arkivat Shtetërore ose me ndonjë ligj tjetër përkatës.

Andaj, nga kjo që u tha më lartë, Agjencia konstaton se PSD, në cilësinë e kontrolluesit, listat e peticionit me të dhëna personale të qytetarëve i ka marrë në pronësi në kundërshtim me nenin 5 të LMDhP-së, si dhe me rastin e zhvillimit të aktivitetit të saj para ndërtesës së QRK-së ka përpunuar duke shpërndarë dhe publikuar të dhëna personale në kundërshtim me nenin 4, paragrafin 1 dhe 2 dhe nenin 5 të LMDhP-së.

Agjencia për Informim dhe Privatësi, pas shqyrtimit të rastit, vërtetimit të gjendjes faktike, duke marrë për bazë kategorinë e të dhënave personale, numrin e madh të të dhënave personale, mënyrën e përpunimit të tyre, legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe bazuar në kompetencat e dhëna me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

[Nënshkruar më datë 05.04.2023]

\_\_\_\_\_  
Zyrtar për Inspektim  
Departamenti për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

### **Këshillë Juridike**

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 ditësh. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

### Vendimi u dërgohet:

1. Partisë Social Demokrate (PSD);
2. Zyrës së Komisioneres;
3. Departamentit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
4. Departamentit Ligjor;
5. Arkivit të Agjencisë.